



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 72/16
Prishtinë, më 9.11.2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Shqipe Pantina, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Munguan: Jelena Bontić, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Enis Spahiu, u.d. Drejtor i Departamentit Ligjor në MF.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Sahit Troshupa nga RTV-21, Fjolla Uka - monitoruese nga KDI, Florina Ejupi - monitoruese nga BIRN, Albulena Nuha - gazetarë nga RTV-21, Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 19.10.2016;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike;**
- 5. Shqyrtimi i Kërkesë së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore lidhur me pagat e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-117 për Akreditimit dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – propozojë që të bëhen disa ndryshime në rendin e ditës. Pika e tretë që ka të bëjë me Shqyrtimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, të shtyhet për një mbledhje tjetër. Rregullorja e Kuvendit e parasheh që shqyrtimi në parim i Projektligjit në Kuvend nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë pune dhe deri një muaj nga dita e shpërndarjes së materialit deputetëve. Meqë ky afat nuk ka kaluar ende është kërkesë edhe e deputetëve që me pas kohë më shumë në dispozicion për analizimin e draftit para shqyrtimit. Përveç kësaj, materiali që është shpërndarë nuk është mirë i lexueshëm dhe unë ka kërkuar nga Ministria e Financave ti përgaditë disa kopje të buxhetit për anëtarët e komisionit në formë të librit dhe ata i kanë sjellur para 15 minutave.

Po ashtu, përveç pikes së tretë, propozojë që të radhitet një pike e re për shqyrtim: Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si pika e pestë e rendit të ditës.

Besa Gaxherri - theksoi se në të ndryshme, grupi punues do të informojë lidhur me punën e tij në analizimin e programit të shpenzimeve të RTK-së për periudhën tetor-dhjetor 2016.

Kryetari konstatoi se Komisioni, unanimisht vendosi që pika e tretë e rendit të ditës: Shqyrtimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, të hiqet nga rendi i ditës. O ashtu Komisioni vendosi që të shtohet pika e re e pestë e rendit të ditës, si: Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 19.10.2016

Kryetari - konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike

Kryetari – ju e dini se në bazë të ligji për faljen e borxheve, ku tanimë ka skaduar afati i mundësisë së paraqitjes së kërkesave për faljen e borxheve. Qeveria e ka proceduar plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit, ku është paraparë që të vazhdohet afati deri më 14 prill 2017. Në seancë plenare, gjatë shqyrtimit të parim të Projektligjit ka pasur opinione të ndryshme që të shtyhet afati, për 1 qershor dhe 1 shtator 2017, për shkak të specifikave të cilat janë përmend e që kanë të bëjnë me diasporën. Propozojë që të bëjmë tri amendamente në projektligj, me tekstin si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1, të riformulohet me tekstin si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Ligji është plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike (ligji bazik), me qëllim të vendosjes së afatit të ri ligjor për përfitimin nga falja e borxheve, sipas dispozitave të ligjit bazik.

Amendamenti 2

Pas nenit 1, të shtohet neni i ri 2, me tekstin si vijon:

Neni 2

Neni 3, paragrafi 1.6. i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si vijon:

1.6 Person – për qëllime të këtij Ligji, nënkupton të gjithë personat fizik dhe juridik (përveç Ndërmarrjeve Shoqërore nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit) që kanë shuma të borxheve publike të pa shlyera ndaj Institucioneve shtetërore dhe Ndërmarrjeve publike.

(Në vazhdim bëhet rirenditja e neneve sipas radhës).

Amendamenti 3

Neni 3, të riformulohet me tekstin si vijon:

Neni 2

Neni 6, paragrafi 4 i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

Subjektet që mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike sipas nenit 4 të ligjit bazik, këtë të drejtë mund ta realizojnë, deri më 1 shtator 2017.

Shqipe Pantina - ne fakt ne e dimë se nuk mund të bëjmë ndryshime në ligjin bazik dhe vetëm në tekstin e Projektligjit që është proceduar nga Qeveria. Përndryshe, vërejtjet e mija janë më shumë në ligjin bazik se sa në projektligj. Nuk e di a kuptova mirë, që ju po propozoni që të bëhen ndryshimet që edhe kompanitë publike të mund të përfitojnë nga falja e borxheve. Shqetësimi im ka qenë për borxhet e Administratës Tatimore dhe Doganave të Kosovës dhe institucioneve tjera shtetërore, ndërsa kompanitë publike janë diçka tjetër dhe ndaj tyre me ligjin bazik janë bërë disa padrejtësi, sepse janë të obliguar të falin borxhe, ndërsa ato nuk mund të përfitojnë nga falja e borxheve.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Raport me rekomandime

- I. Miratohen amendamentet për Projektligjin nr.05/L-119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1 riformulohet me tekstin si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Ligji është plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike (ligji bazik), me qëllim të vendosjes së afatit të ri ligjor për përfitimin nga falja e borxheve, sipas dispozitave të ligjit bazik.

Amendamenti 2

Pas nenit 1, shtohet neni i ri 2, me tekstin si vijon:

Neni 2

Neni 3, paragrafi 1.6. i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si vijon:

1.6 Person – për qëllime të këtij Ligji, nënkupton të gjithë personat fizik dhe juridik (përveç Ndërmarrjeve Shoqërore nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit) që kanë shuma të borxheve publike të pa shlyera ndaj Institucioneve shtetërore dhe Ndërmarrjeve publike.

(Në vazhdim bëhet rirenditja e neneve sipas radhës).

Amendamenti 3

Neni 2 riformulohet me tekstin si vijon:

Neni 3

Neni 6, paragrafi 4 i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

Subjektet që mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike sipas nenit 4 të ligjit bazik, këtë të drejtë mund ta realizojnë, deri më 1 shtator 2017.

II. Raporti me amendmentet procedohet për vlerësim në komisionet tjera të përhershme të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Kërkesë së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore lidhur me pagat e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Kryetari – Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore e ka paraqitur një kërkesë për caktimin e pagave të anëtarëve të Këshillit, ndërsa Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga komisioni ta shqyrtojë kërkesën dhe të hartojë raportin me rekomandime në Kuvend. Siç e dijmë Këshilli nuk është organ ekzekutiv, dhe nuk mund të marrin pagë por komensime. Unë mendoj se duhet përkrahur ky institucion dhe në qështjen e kompensimeve anëtarët e këtij Këshilli të krahasohen me anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media. Propozojë që të rekomandojmë që kompensimi për kryetarin e Këshillit të jetë 800 euro bruto në muaj, për nënkryetarët 700 euro bruto në muaj dhe për anëtarët 600 euro bruto në muaj.

Shqipe Pantina – ne si komision në një mbledhje më herët e kemi pasur një kërkesë të natyrës së tillë për caktimin e pagave apo kompensimeve, kam thënë në atë takim dhe prap po themë se Qeveria do të duhej të procedonte Projektligjin për pagat e zyrtarëve të lartë publik sepse ne po biem në pozita të palakmueshme me këto kërkesa. E dyta unë jam absolutisht kundër këtyre pagave të larta të këtyre anëtarëve të Këshillit sepse bordi mban mbledhje njëherë në muaj dhe secili prej tyre ka një punë tjetër që siguron të hyra të tjera. Propozimi im është që ti krahasojmë me kompensimet që marrin asambleistët komunal.

Kryetari – ëështjen e nevojës së procedimit të Projektligjit që rregullon pagat e zyrtarëve të lartë publik e kemi ngritur disa herë, por deri sa të vjen projektligji ne duhet të procedojmë me propozim për këtë rast, pasi që edhe jemi të ngarkuar nga Kryesia që të raportojmë në Kuvend.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota Për, asnjë Abstenim dhe tre Kundër, për Kuvendin e Kosovës nxori këtë

Propozim – Vendim

Për caktimin e kompensimit të kryetarit, nënkryetarëve dhe anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

1. Kryetarit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i caktohet kompensimi në shumën prej 800 euro, bruto në muaj.
2. Nënkryetarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i caktohet kompensimi në shumën prej 700 euro, bruto në muaj.
3. Anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i caktohet kompensimi në shumën prej 600 euro, bruto në muaj.

4. Niveli i pagës së kryetarit, nënkryetarëve dhe anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, sipas pikës 1 deri në 3 të këtij Propozim-vendimi, zbatohet deri në miratimin e Ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publikë.
5. Shfuqizohet Vendimi nr.03-V-222, datë 27 tetor 2009, i Kryesisë së Kuvendit, për caktimin e pagave për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-117 për Akreditimit dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari – thesroi se në bazë të vlerësimit të ndikimit buxhetor, Projektligji përmban një kosto shtesë prej 70,000 euro, që mendohet se është e përballeshme, pasi që Agjencia e Akreditimit është e themeluar dhe kjo kosto mund të absorbohet brenda ndarjeve buxhetore. Amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-117 për Akreditimit, përmban kosto të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
 2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin nr.05/L-117 për Akreditimin, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- #### **6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

Kryetari – lidhur me Projektligjin për Obiliqin ne kemi caktuar një grup punues për të shqyrtuar Projektligjin dhe amendamentet e komisionit funksional, ku kemi mbajtur një takim bashku me grupin punues të komisionit funksional, ku kanë qenë prezent edhe zv.ministrin i financave dhe zv. ministri i zhvillimit ekonomik dhe nuk kemi gjetur zgjidhje. Ndërkohë, komisioni funksional ka tërhequr raportin paraprak dhe tani ka dorëzuar një raport i ri që e kemi përpara, ku janë bërë disa ndryshime. Çështja kryesore ka qenë mundësia e shfrytëzimit të taniemes për financim në komunën e Obiliqit dhe komunitetin rreth saj. Me miratimin e Ligjit për Trepçën është hapur mundësia që tani të mund të ndahet në përqindje në atë komunë dhe për zhvillimin e komunitetit në lokacionin ku ndodhet njësi biznesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sportit, shëndetësisë dhe arsimit.

Shqipe Pantin – unë nuk kam pasur mundësi të njoftohem më herët me qështjen e këtij Projektligji dhe nuk mundem të deklaroj as për, dhe as kundër dhe pikërisht për këto arsye voto ime është e papërcaktuar.

Safete Hadergjonaj – siç theksoi edhe kryetari ne e kemi shqyrtuar këtë Projektligj dhe ka qenë problemi tek qështja e financimit për zonën e veçantë të Obiliqit. Miratimi i Ligjit për Trepçën krijuar mundësinë që të bëjmë zgjidhjen dhe tani me amendamentin 10 të propozuar nga komisioni funksional është rregulluar kjo çështja e financimit përmes taniemes dhe mendohet se tani mund ta procedojmë më tutje këtë Projektligj.

Bali Muharremaj - edhe unë jam që të përkrahim këtë Projektligj dhe amendamentet e komisionit funksional, miratimi i të cilit është në të mirën e qytetarëve të Obiliqit dhe do të duhej që sa më shpejtë të miratohet në Kuvend dhe të fillojë të zbatohet, pasi që edhe ashtu është vonuar.

Enver Hoti – miratimi i këtij ligji është vonuar dhe po më vjen mirë që tash po krijohen kushtet që të ndajmë mjete dhe të mbështesim me ligj, zonën e rrezikuar të Obiliqit dhe komunitetin që jeton aty dhe rreth tij.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni me shtatë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për Projektligjin nr.05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, përmbajnë implikime buxhetore shtesë të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

7. Të ndryshme

Kryetari – njoftojë anëtarët se me datë 14 nëntor 2016 në këtë sallë, prej orës 9:30-11:00, do të mbahet një takim në mes Komisionit dhe Misionit të FMN-së për Kosovën, ku do të diskutohet për Buxhetin 2017.

Shqipe Pantina – në procesverbal kur është diskutuar Raporti nëntëmujor dhe programi i shpenzimeve për periudhën tetor-dhjetor 2016 është shkruar mirë. Mirëpo në Kryesinë e Kuvendi është kuptuar ndryshe që rekomandimi i Komisionit. Kryesia e Kuvendit e ka kuptuar se grupi punues ka punuar për programin e shpenzimeve për 2016 dhe jo për tremujorin e fundit. Duhet të sqarohet që mos të ketë kolizion mes grupit punues apo Komisionit edhe Kryesisë.

Besa Gagjerri - si grup punues i autorizuar nga Komisioni për analizimin e projeksioneve të shpenzimeve të RTK-së për periudhën tetor-dhjetor 2016, kemi zhvilluar dy takime me përfaqësuesit e RTK-së. Në takimin e parë që kemi zhvilluar në objektin e RTK-së, me dt.24.10.2016, kemi kërkuar listën e pagave, listën e kontratave dhe aneks kontratave si dhe listën e kontratave për shërbime të veçanta apo kontratat mbi vepër. Regulloren se në qfarë baze i kanë të percaktuara pagat bordi, në takimin e parë nuk na është ofruar asnjë informatë. E keqja është që as bordi nuk i ka pasur ato informata asnjëherë. Ne si grup punues kemi mbajtur edhe një takim me datë 3.11.2016 ku e kemi ftuar Kryetarin dhe anëtarët e bordit dhe kemi kërkuar që paraprakisht informtat të na dërgohen me shkrim dhe në formë elektronike. Kryetari dhe dy anëtarët e Bordit kanë marrë pjesë në takim dhe kanë sjellë listën e punëtorëve në RTK, por vetëm me emra e mbiemra por jo edhe për pagën sa e kanë. Në bazë të programit të shpenzimeve të dërguar nga RTK, në Komision kemi pasur të dhëna për numrin e të punësuarve prej 743 të punësuar, kur ka ardhur lista kemi parë se 729 janë punëtorë të rregullt dhe kemi gjetur afërsisht 200 punëtorë që janë me kontratë mbi vepër. Grupi Punues duhet takohet edhe njëherë dhe të nxjerr rekomandimet konkrete.

Enver Hoti - në takimin e parë të grupit punues ne jemi takuar me bordin dhe disa drejtorë të RTK-së dhe kemi parë se gjendja në RTK nuk është aspak e mirë. Ne kemi parë edhe që Bordi drejtues është aty vetëm sa për të qenë sepse ndaj tyre nuk jep llogari menaxhmenti i RTK-së. Njëri anëtar i bordit ka deklaruar se nga shkurti ka kërkuar qasje në listat e punëtorëve dhe atij jo vetëm që nuk iu ka dhënë lista

por përkundrazi është akuzuar se ka tendenca për ndërhyrjen në punën e pavarur të RTK-së. Ndërkohë është sjellur një listë ku shifet se janë dikun 940 punëtor, por nuk i kanë sjellur aneks kontrat dhe informatat tjera që kemi kërkuar.

Shqipe Pantina – pajtohem që grupi punues ta vazhdojë punën e tij. Por të mos kufizohet vetëm tek pagat, por të kërkohet që ti sjellin të gjitha kontratat e shërbimeve. Ndërsa mënyra se si ka reaguar menaxhmenti duke akuzuar Kuvendin është jo e ndershme dhe bordi është dashur të reagojë, pasi që njëren prej detyrave dhe përgjegjësive kryesore e ka edhe zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorit menaxhues.

Kryetari – propozojë që Komisioni të angazhojë një ekspert që do ti ndihmojë Komisionit në analizën e buxhetit dhe kërkesave buxhetore 2017 për nevojat të Komisionit, i cili do të paguet nga buxheti i Komisionit.

Në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni vendosi angazhimin e një eksperti për analizën e buxhetit dhe kërkesave buxhetore 2017 për nevojat të Komisionit, i cili do të paguet nga buxheti i Komisionit në pajtim me Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani